



FORCA KRIJUESE E ARTIZANEVE TË LUSHNJËS



Botimi i kësaj broshure u realizua me mbështetjen financiare të Ambasadës Gjermane, Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë botim u përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e Ambasadës Gjermane.



**FORCA
KRIJUESE E
ARTIZANEVE
TË LUSHNJËS**

Refleksione 2025

FUQIZIM I ARTIZANEVE NXITJE E EKONOMISË SË KOMUNITETEVE LOKALE

Broshura “Forca krijuese e artizaneve të Lushnjës” botohet në kuadër të projektit, “Fuqizim i artizaneve – Nxitje e ekonomisë së komuniteteve lokale”, mbështetur financiarisht nga Ambasada Gjermane, Tiranë, zbatuar nga “Refleksione” në Bashkinë e Lushnjës, në bashkëpunim me autoritetet e kësaj bashkie. Projekti synoi t’i fuqizojë gratë dhe vajzat artizane në Bashkinë e Lushnjës, duke u ofruar edukim ligjor, pavarësi financiare përmes rritjes së të ardhurave nga shirja e punimeve të tyre me gre, shtiza, qëndisje si edhe rritjen e rolit të tyre në familje dhe komunitet.

Ky projekt ofroi gjithashtu dije digjitale dhe mentorim për të ruajtur traditën dhe transmetuar atë tek brezi i ri i artizaneve. Në bashkëpunim me Bashkinë e Lushnjës dhe nën kujdesin e posaçëm të kryetares së Bashkisë, Znj. Eriselda Sefa, projekti ngriti edhe “Qendrën Artizanet e Lushnjës” një hapësirë ku gratë dhe vajzat artizane mblidhen, shkëmbejnë përvojat e tyre, ndërmarrin nisma për të rritur të ardhurat, nxitur përmirësimin e ekonomisë në komunitetet e tyre, kontribuar në vendimet e familjes, sfiduar rolet gjinore dhe nxitur barazinë. Në qëndër të kësaj broshure janë artizanet e Lushnjës, rrëfimet e tyre, pasioni për të zhvilluar traditën dhe përcjellë atë tek brezi i ri si pjesë e pandarë e trashëgimisë kulturore si edhe fuqizimi i tyre nga projekti.

Realizuan broshurën:

Ani Ruci	Drejtoreshë projekti
Meliha Zyberaj	Eksperte arizanati
Aurela Zhubi	Eksperte Digital Marketing
Ariola Korreshi	Koordinatorë Lokale
R&T Advertising	Design

PARATHËNIE

Historia e grave artizane në Shqipëri është një trashëgimi shekullore, pasuri kombëtare ku edhe punimet artizanale janë shprehje e kulturës, identitetit dhe mbi-jetesës ekonomike.

Artizanet e Lushnjës janë një grup grash dhe vajzash të reja që ndërthurin këtë trashëgimi me artin artizanal bashkëkohor. Pasioni dhe vullneti i tyre për të ruajtur dhe transmetuar traditën e punimeve me grep, shtiza dhe qëndisje është mbresëlënës po të kihen parasysh vështirësitë e jetës së përditshme. Gratë artizane të Lushnjës merren kryesisht me bujqësi. Prodhimet e tyre bujqësore i shesin në tregjet lokale dhe shpesh për shkak të motit nuk marrin prodhime. Në kohën e tyre të lirë, pas punëve të vështira të ditës, ato bëjnë punime artistike. Pasioni dhe aftësitë e tyre vlerësohen si një nga krenaritë e Lushnjës, ruajtjen e traditës, kalimin e saj nga brezi në brez dhe realizimin e potencialit të tyre artistik.

Për të promovuar kontributin e grave artizane në ruajtjen dhe pasurimin e traditës shoqata e grave “Refleksione” boton broshurën, “Forca krijuese e artizaneve të Lushnjës”, në kuadër të projektit, “Fuqizim i artizaneve – Nxitje e ekonomisë në komunitetet lokale”, të mbështetur financiarisht nga Ambasada Gjermane, Tiranë, zbatuar nga kjo shoqatë në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Lushnjës.

“Refleksione” falenderon përzemërsisht Ambasadën Gjermane në Tiranë për mbështetjen financiare të projektit, “Fuqizim i Artizaneve – Nxitje e ekonomisë së komuniteteve lokale”, Bashkia Lushnjë, në kuadër të të cilit u mundësua botimi i kësaj broshure.

Më tepër informacion mund të gjeni në website: www.artizanetelushnjes.al

Ani Ruci

Drejtoreshë Ekzekutive
Refleksione

KONTRIBUESE NË RUAJTJEN DHE PASURIMIN E TRADITËS

Punimet artistike në grep, shtiza dhe qëndisje të artizaneve në Bashkinë e Lushnjës janë dëshmi e forcës së tyre krijuese, kontributit në ruajtjen dhe pasurimim e trashëgimisë kulturore nga brezi në brez. Punimet e tyre janë gjithashtu një urë lidhëse mes traditës dhe modeleve bashkëkohore, që pasqyrojnë kujtimet kolektive, vlerat dhe traditat e komunitetit të tyre. Ndryshe nga riprodhimet tregëtare punimet e tyre me dorë janë unike, ofrojnë histori, teknika autentike dhe përdorim të materialeve tradicionale. Punimet e tyre artizanale janë pjesë e rëndësishme e suvenireve për turistët dhe promovojnë trashëgiminë kulturore të Shqipërisë.

Rrëfimet e artizaneve të Lushnjës nga jeta e tyre, e përditshmja e vështirë në bujqësi dhe pasioni për të realizuar punime artistike me dorë dëshmojnë forcën e tyre të pakufizuar krijuese.



FATMIRA XHEBEXHIU

“Jam 54 vjeç. Punimet e para me grep dhe shtiza i kam filluar 40 vjet më pare. Mjeshtërinë në punimet artizanale me dorë e kam një trashëgimi të çmuar nga nëna ime, që ka këmbëngulur ta mbajë traditën të gjallë dhe ta përcjellë më tej”.



XHEVAHIRE PAJA

“Më tërheq shumë puna e dorës. Punimet me grep i kam mësuar nga shoqet. Jam e gëzuar që do të kemi për here të pare një qendër tonën, ku do të mblidhemi të bisedojmë, të shkëmbejmë modele, përvoja dhe të fuqizohemi.”

**MELEQE XHEBEXHIU**

“Kam dy vajza që u kam mësuar të bëjnë punë me grep, shtiza dhe të qëndisin, ashtu si bëri nëna ime me mua dhe gjyshja ime me mamanë time.”

**VJOLLCA XHEPEXHIU**

“Merrem me bujqësi, kam sipërfaqje me agrume, ullishte dhe prodhimet i shes në treg. E kam pasion punën e dorës dhe në mbrëmje ulem dhe bëj punime artistike me grep dhe shtiza. Dëshëroj dhe përpiqem që tradita jonë artizanale të ruhet edhe përmes punës time”

**ANIFE TOSKA**

“Punoj me grep dhe shtiza, bëj gjithcka: triko, kapuçë, doreza, tantella. I kam mësuar vetë. Kam shumë dëshirë të shkoj në panaire dhe të gjej blerës për punimet e mia.”

**LIDA XHEPEXHIU**

“Vij nga një familje e madhe me 11 vetë: prindërit, 8 motra dhe një vëlla. Me motrat mësonim nga njëra-tjetra të bënim punë dore me grep. Nëna punonte në tezgjah dhe tirte leshi për qilima dhe mbulesa për dimër.”



TALIBE XHEPEXHIU

“Merrem me bujqësi por edhe me punë dore. Nëna ime më mësoi punën me shtiza dhe grep që kur isha e vogël, tetë a nëntë vjeç. Dëshëroj të marr pjesë në panaire, të coj atje punimet e mia me shtiza, të gjej blerës dhe të rris të ardhurat për familjen.”



SARIANA LLAPUSHI

“Jam nxënëse në shkollën “Liri Kazazi” dhe marr pjesë në programin kombëtar “Art & Zeje ” të Ministrisë së Arsimit që po zbatohet edhe në shkollën time. Kam mësuar artin e punimeve me dorë në qëndistari që më pëlqen shumë. Jam e gëzuar që vazhdoj traditën e zejtareve me eksperiencë në qëndistari.”



SUADA HODO

“Në programin kombëtar Art & Zeje të shkollës time, “Liri Kazazi” kam mësuar të bëj byzylykë, gjë që më pëlqen shumë. Ngjyrat e gurëve i zgjedh sipas dëshirës dhe fantazisë time. Dëshëroj të zhvilloj më tej pasionin tim dhe t’i ekspozoj punët e mia në platformën digjitale që është ndërtuar nga projekti “Fuqizim i artizaneve – Nxitje e ekonomisë së komuniteteve lokale” që të gjej më shumë blerës dhe të ndihmoj familjen me të ardhurat që do fitoj.”



ALMA SYLA

Mësuese e gjuhës angleze në shkollën e mesme të fshatit Hysgjokaj që drejton në këtë fshat degën e fondacionit hollandez “New Day Impact”, që ndihmon njerëzve në nevojë. “Gratë zejtare janë kryesisht shtëpiake, nuk kanë një profesion. Zejtaria është krenari e kësaj zone. Rritja e kapaciteteve të grave artizane nga projekti i shoqatës “Refleksione” besoj se do t’i ndihmojë ato të ngrenë biznese të vogla, të dalin në treg me punimet e tyre artizanale, të fitojnë të ardhura, të ndihmojnë familjet e tyre dhe përmirësojnë jetesën e gjithë komunitetit”



RUAJTJA E IDENTITETIT KULTUROR

Transmetimi i mjeshtërive tradicionale të grave artizane tek brezat e rinj është një proces shumë i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit kulturor, nxitjen e pavarësisë së tyre ekonomike dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme artizanale.

Punimet artizanale në grep, shtiza dhe qëndisje të artizaneve të Lushnjës përbëjnë “të dhëna të prekshme” të historisë, që lidhin të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ato e mbajnë gjallë kujtimin e komuniteteve dhe janë një „trashëgimi e gjallë” që duhet ruajtur dhe kaluar tek brezat e rinj për të siguruar vazhdimësinë e tyre. Këto punime lidhin komunitetet lokale me rrënjët e tyre pasi transmetimi i aftësive artizanale tek brezat e rinj siguron diversitetin kulturor në një botë të globalizuar.

Mbajtja gjallë e mjeshtërive tradicionale të punimeve me grep, shtiza dhe qëndisje i shërbën edhe fuqizimit ekonomik të artizaneve. Punimet e tyre janë një burim të ardhurash sidomos për gratë në zonat rurale si rasti i artizaneve në fshatin Hysgjokaj në bashkinë e Lushnjës. Aftësitë artizanale i ndihmon ato të shndërrojnë njohuritë tradicionale në mjete jetese të qëndrueshme.

Por jo vetëm kaq. Punimet artizanale janë shpesh një aktivitet të cilat forcojnë lidhjet shoqërore dhe nxisin ndjenjën e përkatësisë. Kalimi i teknikave nga gjyshet tek nënat dhe që këtej tek vajzat e tyre dhe që këtej nga brezi në brez, ruan jo vetëm një produkt, por edhe vlerat e paraardhësve, rrëfimin e historive dhe praktikat shoqërore të komunitetit. Ato luajnë rol pozitiv në fuqizimin dhe vetëvlerësimin e artizaneve. Kalimi i mjeshtërive artizanale ndër breza është një urë që lidh traditën me inovacionin. Artizanet e reja i kombinojnë teknikat tradicionale me dizajne modern duke krijuar forma të reja të shprehjes artistike.

Projekti, “Fuqizimi i grave artizane – Nxitje e ekonomisë së komuniteteve lokale”, në bashkinë e Lushnjës, realizoi trainimin e vajzave dhe grave të reja artizane me Meliha Zyberaj, mjeshtre artizane, e certifikuar nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë me teknikat e endjes në tezgjah.

EDUKIM LIGJOR – FUQIZIM I ARTIZANEVE

Edukimi ligjor vlerësohet si një faktor i rëndësishëm në fuqizimin e artizaneve. Përmes tij atyre u ofrohen njohuri për të kapërcyer barrierat gjinore, për të mbrojtur punimet e tyre dhe fituar pavarësi ekonomike. Projekti “Fuqizim i artizaneve - Nxitje e ekonomisë së komuniteteve lokale” u mundësoi grave artizane të Lushnjës marrjen e njohurive për ligjin nr. 70/2016, “Për artizanatin në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj, i hartuar në bashkëpunim midis Dhomës Kombëtare të Artizanatit, Shqipëri dhe Dhomës së Artizanatit Koblenz, Gjermani, mbron pronën e tyre artistike, parandalon përdorimin e paautorizuar të punimeve artizanale, promovon kualifikimin profesional dhe përfshin dispozita për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Njohja me këtë ligj dhe në përgjithësi edukimi ligjor i grave artizane u jep atyre mundësi të bëhen nga punëtore të padukshme, që punojnë në banesat e tyre, në sipërmarrëse apo të vetëpunësohen, të ngrejnë biznese të vogla, të aftësohen për të adresuar pazaritë gjinore dhe përmirësojnë aksesin e tyre në drejtësi. Edukimi ligjor i ndihmon ato të kuptojnë më mirë të drejtat e tyre, të rrisin vetëbesimin dhe kalojnë nga rolet tradicionale dhe të nënvlerësuara drejt një pozicioni më të sigurtë, më të fuqizuar në ekonomi.

Njohja e legjisllacionit për artizanatin ndikon në fuqizimin e grave artizane pasi i transformon ato nga prodhuese të cënueshme në aktore ekonomike me fuqinë për të mbrojtur të drejtat e tyre, rritur të ardhurat ndikuar në komunitetet e tyre, të ndërjegjehme për të drejtat e tyre ligjore dhe mbrojtjen nga diskriminimi gjinor apo stereotipet që pengojnë potencialin e tyre ekonomik.

Njohuritë ligjore i ndihmojnë gjithashtu artizanet të kuptojnë të drejtat e pronësisë intelektuale duke u lejuar atyre të mbrojnë dizenjot tradicionale dhe teknikat nga imitimi komercial. Të pajisura me njohuri për të drejtat e tyre, gratë artizane mund t'i trajtojnë më mirë ligjet familjare dhe të trashëgimisë, duke rritur fuqinë e tyre vendimmarrëse brenda familjes dhe në aktivitetet e tyre të biznesit.

MARKETING DIGJITAL – FUQIZIM I ARTIZANEVE


Ruajtja dhe pasurimi i traditës së punimeve artizanale, përmirësimi i ekonomive familjare të artizaneve nga rritja e të ardhurave prej shitjes së tyre kufizohet nga mugesia e njohurive për marketingun digjital. Këto njohuri janë të domosdoshme sidomos nga brezi i ri që ka pasion dhe dëshirë të merret me aktivitet artizanal.

Gratë dhe vajzat artizane kanë nevojë për aftësimin në marketingun digjital sepse ai ofron mundësi të pafundme, fleksibilitet dhe pavarësi financiare. Marketingu digjital i fuqizon artizanet sepse u ofron mjete me kosto efektive për të kapërcyer kufizimet gjeografike, hyrë në tregun lokal, kombëtar apo rajonal dhe ndërtuar pavarësi financiare. Platformat digjitale Instagram, Facebook etj u japin mundësi artizaneve të shfaqin drejtpërdrejt tek konsumatorët produktet e tyre unike, të punuara me dorë, duke anashkaluar ndërmjetësit dhe duke përmirësuar fitimet e tyre. Mjetet digjitale u lejojnë grave të menaxhojnë shitjet e punimeve artizanale nga banesat e tyre duke i ndihmuar ato të balancojnë përgjegjësitë tradicionale shtëpiake, punët në bujqësi me kohën kushtuar punimeve artizanale që kanë potencialin të shndërrohen në aktivitet ekonomik.

Marketingu digjital, sidomos përmes videove, u mundëson artizaneve të tregojnë historitë që qëndrojnë pas punimeve të tyre me grip, shtiza dhe qëndisje, gjë që e rrit vlerën e punimeve. Mjetet digjitale u lejojnë artizaneve të tregojnë procesin e tyre krijues në mediat sociale dhe të ndërtojnë lidhje emocionale me klientët potencialë.

Njohuritë digjitale mundësojnë transformimin e artizaneve në sipërmarrëse digjitale, gjë që rrit të ardhurat por edhe statusin në familjet dhe komunitetin e tyre lokal. Aftësitë dixhitale u ofrojnë artizaneve fleksibilitetin për të punuar nga shtëpia, u japin mundësi të balancojnë përgjegjësitë shtëpiake, kujdesin ndaj fëmijëve dhe kujdesin ndaj të moshuarve me biznesin e tyre. Artizanet e Lushnjës, pjesëmarrëse në aktivitetet e projektit “Fuqizim i artizaneve – Nxitje ekonomisë së komuniteteve lokale” u ndërgjegjësuat për domosdoshmërinë e njohurive

digjitale gjatë workshop-it kushtuar për digjital marketing. Njohuritë digjitale të ofruara nga ky projekt përfshinë edhe krijimin e platforma online, e cila ofroi një hapësirë digjitale ku gratë artizane në Bashkinë e Lushnjës mund të prezantojnë, promovojnë dhe shesin produktet e tyre në mënyrë të pavarur, të kenë akses në tregje më të gjera dhe të nxisin zhvillimin ekonomik në komunitetet lokale ku jetojnë.



QENDRA ARTIZANET E LUSHNJËS

Ngritja e kësaj qendre është një nga arritjet më të mëdha dhe të qëndrueshme të projektit, "Fuqizim i artizaneve - Nxitje e ekonomisë së komuniteteve lokale." Kjo qendër është e para e këtij lloji në Bashkinë e Lushnjës, e vendosur në mjediset e „Qendrës së Artit Vaçe Zela“ në sajë të mbështetjes së fuqishme të Znj. Eriselda Sefa, kryetare e Bashkisë së Lushnjës, si një dëshmi e angazhimit të saj të palëkundur për të mbështetur artizanet duararta të Lushnjës, që mbajnë gjallë traditat e punimeve artistike me grep, shtiza dhe qëndisje

“ Qendra Artizanet e Lushnjës „ është një hapësirë ku artizanet e Lushnjës do të takohen, bisedojnë, shkëmbejnë përvoja. Ajo është njëkohësisht edhe një shtysë për të zgjeruar tregjet për shtijen e punimeve artizanale, rritur të ardhurat fituar pavarësi financiare, përmirësuar jetesën në familje dhe komunitetet lokale.

Kjo qendër do të ndihmojë artizanet e Lushnjës të mbajnë gjallë aftësitë, teknikat, trashëgiminë kulturore tradicionale dhe t’ia japin ato brezit të ri. Në këtë qendër ato mund të bisedojnë sesi të përmirësojnë teknikat, të kombinojnë tradicionalen me modernen dhe plotësojnë kërkesat aktuale të tregut. Përveç kësaj, qendra do të shërbejë si një hapësirë e sigurtë komunitare ku artizanet e Lushnjës do të mblidhen, mbështesin njëra tjetrën dhe reduktojnë izolimin duke nxitur fuqizimin ekonomik, ruajtur trashëgiminë kulturore dhe bërë progress në barazinë gjinore. Rritja e të ardhurave nga shitja e punimeve artizanale pritet të shoqëohet nga rritja e rolit të gratë artizane në familjet dhe komunitetet e tyre.

“Qendra Artizanet e Lushnjës„ pritet të shërbejë edhe për zgjerimin e dijeve që u përfatuan nga zbatimi i projektit, “ Fuqizim i artizaneve - Nxitje e ekonomisë së komuniteteve lokale” lidhur me ligjet, marketimin digjital , platformën digjitale me anë të bashkëpunimeve dhe treinimeve të tjera. Ajo mund të lidhet me të tjera qendra të kësaj natyre jo vetëm në Shqipëri por dhe në rajon për të bashkëpunuar, ruajtur trashëgiminë kulturore, pasuruar me dizenje modern, rritur të ardhurat dhe përmirësuar nivelin e jetesës.

Nga inagurimi i Qendrës Artizanet e Lushnjës dhe aktivitetet e projektit













Refleksione
Gjërat janë gati të ndryshojnë

